

KËRKESË
Nr. 6979, datë 13.11.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Shkodër-Hani i Hotit (objekte)”. Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të

paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit objekte.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 11648600 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS**

Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

**LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER OBJEKTET QE PREKEN NGA NDERTIMI
RUGES SHKODER-HANI I HOTIT(Pas ndryshimit te projektit)**

Lista nr.2

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Emertimi I objektit	Vlera	Shenime
1	Tom		Gjetja	1465	803/2	Mure rrethues	660672	leje ndertimi
2	Gjon		Curraj	1020	110	Mure rrethues	498294	leje ndertimi
3	Pashko		Kokaj	1964	986	Karburant	8615707	leje ndertimi
4	Shoq."Ada Petrol"	Agustin	Uldedaj	1964	992	Karburant	953232	leje ndertimi
5	Smajl, Fatmir	Ali	Rexha	1766	1067/19	Mure rrethues	920695	leje ndertimi
	SHUMA						11648600	

